



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Nr. Prot.: Unit: Jedinita:	ZK
Nr. Prot.: Br. Prot.:	124/2022
Nr. i faqeve: No. of pages: Br. stranimet:	-03-
Data: Datum:	20.04.2022
Proshtrime:	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Ref. nr.124/2022

Për: Menaxherët e Institucioneve Shëndetësore të Republikës së Kosovës;

Nga: Dr.Pleurat Sejdiu, Kryetar i OMK-së;

Lënda: Qarkore informative lidhur me përgjegjësinë penale të mjekëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë mjekësore;

Datë: 20 prill 2022

Të nderuar anëtarë të OMK-së,

Me qëllim të ushtrimit të detyrave dhe obligimeve ligjore për mbrojtjen e të drejtave profesionale të mjekëve në ushtrimin e profesionit, OMK në kuadrin e aktiviteteve të zakonshme dhe atyre të projektuara, me datë 14 prill 2022 ka mbajtur seminarin me titull “Përgjegjësia penale dhe etike në ushtrimin e veprimtarisë mjekësore”. Në këtë ngjarje, e cila ka pasur për qëllim kryesor ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe drejtuese të strukturave të brendshme profesionale dhe përfaqësuese, qëllimi tjetër ka qenë edhe i bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me rastin e trajtimit të rasteve në të cilat mjekët gjatë ushtrimit të profesionit mund të inkriminohen në përgjegjësi ligjore.

Nga diskutimet e tilla është vënë në pah se me ndryshimet në Kodin Penal të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 19 prill 2019, ndër dispozitat që kanë pësuar ndryshim është edhe dispozita përkitazi me përkufizimin e veprës penale “Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”. Për derisa në Kodin paraprak, respektivisht Kodin NR. 04/L-082 vepra penale e trajtimit të pandërgjegjshëm mjekësor ka mundur që të kryhet vetëm me formën e fajsisë me dashje eventuale, tani me Kodin NR. 06/L-074 kjo veprë penale mund të kryhet edhe nga pakujdesia.

Inkriminimi i përgjegjësive penale duke njohur mundësinë që kjo veprë penale mund të kryhet edhe nga pakujdesia, ka zgjeruar dukshëm përgjegjësinë penale të mjekëve. Kështu që derisa me Kodin paraprak kjo veprë ka mundur të kryhet vetëm me dashje eventuale, kryerja e kësaj vepre nga pakujdesia nuk e ka marr në përgjegjësi penale mjekun. Kështu që sipas përkufizimit të dashjes eventuale, e që është përkufizim identik në të dy kodet, mjeku konsiderohet se e ka kryer veprën penale me dashje eventuale kur ai është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e pasojës së ndaluar. Ndërkaq, veprën penale mjeku e kryen nga pakujdesia në rastet kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj, e që kjo paraqet pakujdesinë e vetëdijshme. Ndërkaq pakujdesia e pavetëdijshme ekziston atëherë kur mjeku është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund

të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.

Krahas zgjerimit të inkriminimit të përgjegjësive penale tek vepra penale e trajtimit të pandërgjegjshëm mjekësor, kjo dispozitë ka pësuar edhe një ndryshim tjetër i cili ka të bëjë me elementet e kësaj vepre penale. Kështu që për derisa sipas kodit paraprak kjo vepër është konsideruar që kryhet me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore kur mjeku përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose nuk përdor masat përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit, në versionin e ri kjo vepër penale kryhet kur mjeku me rastin e dhënies së shërbimeve të kujdesit shëndetësor, përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose në ndonjë mënyrë tjetër haptazi nuk i zbaton rregullat e profesionit të kujdesit shëndetësor ose haptazi vepron në mënyrë të pakujdesshme, duke shkaktuar kështu keqësimin e sëmundjes ose dëmtimin shëndetësor të personit tjetër. Pra, siç shihet tani elementet e kësaj vepre penale kanë ndryshuar pasi që kjo vepër tani ndërlihet edhe me obligimet profesionale të mjekut apo edhe kur mjeku vepron në mënyrë të pakujdesshme, janë elemente që më parë nuk kanë qenë të përfshira në tekstin ligjor.

Ajo për të cilën shprehim shqetësimin tonë si organizatë dhe si palë e interesit në çështje profesionale, është fakti se gjatë procesit të draftimit, diskutimeve publike dhe procedurës parlamentare, OMK asnjëherë nuk është konsultuar qoftë nga Qeveria e Kosovës apo edhe nga Kuvendi i Kosovës me rastin e miratimit të tij.

Zgjerimi i fushës së përgjegjësive në ushtrimin e profesionit mjekësor ka mobilizuar OMK-në në mënyrë që të ofrohet këshillimi i avansuar ligjor për anëtarësinë e saj. Prandaj për çdo eventualitet, OMK do t'i ofrojë të gjithë anëtarëve të saj, në çdo kohë, duke shfrytëzuar kapacitetet profesionale të Shërbimit Profesional të Odës, për t'i këshilluar lidhur me çështjen në fjalë.

OMK po ashtu ka filluar që të ndërmerri iniciativa lidhur me avokimin dhe lobimin për draftimin dhe miratimin sa më të shpejt të Ligjit për Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Profesionistëve Shëndetësor, ligj ky i cili do të definonte në mënyrë të qartë autorizimet dhe përgjegjësitë profesionale të mjekut gjatë dhënies së shërbimit mjekësor.

Po ashtu, ju njoftojmë se jemi duke mbajtur kontakte të vazhdueshme insitucionale me nivelin prokurorial, gjyqësor dhe atë policor, në mënyrë që të ofrojmë asistencë profesionale gjatë trajtimit dhe ndjekjes penale tek rastet kur mjeku është palë, në mënyrë që të ruhet dhe mbrohet personaliteti profesional i mjekëve nga cilado pikëpamje.

Poashtu, dëshirojmë të bëjmë me dije se bazuar në nenin 33, Pëlqimi për trajtim pas informimit, të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjeksore është obligim ligjor i sejcilit udheheqës të institucionit shëndetësor të siguroj që formularët e Pëlqimeve respektive të jenë të aprovuara dhe gatëshme për sejcilën procedurë. Prandaj, duhet të siguroheni se pacienti të kuptoj dhe të nënshkruaj pëlqimin para çdo procedure të parapëre me këtë nen.

Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjeksore, mund ta gjeni dhe ta shkarkoni në:

<https://omk-rks.org/wp-content/uploads/2020/01/KO-32-2019-Kodi-Etik-i-OMK-s%C3%AB.pdf>

Si përfundim, kërkohet nga Ju që përmes vartësve Tuaj të siguroni që i gjithë personeli i Juaj të jetë i informuar për përmbajtjen e kësaj qarkoreje.

Ju lutemi që mos të hezitoni që ta na kontaktoni për sqarime të mëtutjeshme.

Me respekt,

Prishtinë, 20 prill 2022

Dr. Pleurat Sejdiu
Kryetar i OMK-së

